



# SBASHK

## Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

# Arsimimi

### KULTURA E NJERIUT



*Ë-buletin*

*Qershor, 2017*

Fotoreportazh nga bregdeti shqiptar

## 420 anëtarë të SBASHK-ut në shoqëri me valët e qeta të detit



SBASHK-u edhe këtë vit po vazhdon me traditën e mirë për dërgimin në bregdetin shqiptarë të anëtarëve të vetë nga e tërë Kosova. Me qëllim që çdo gjë këtë rrjedhë të mbarë Këshilli Drejtues ka emëruar një komision që do të bëjë gjithë përgatitjet e duhura lidhur me këtë... (faqe 4)

Kolegët tanë na shkruajnë nga mjediset e tyre të punës

### Aktivitetet e SBASHK-ut nuk kanë të ndalur



Veprimtarët e SBASHK-ut Bardh Bardhi, Blerim Mehmeti e Fadil Halimi ,krahas angazhimeve sindikale ....(faqe 6)

### SBASHK-u po fiton në gjykatë betejat me komunat

Dega në Vushtrri e Gjykatës Themelore në Mitrovicë ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e SBASHK-ut ....(faqe 8)

### Intervistë me mësuesen Idrisha Bytyqi

### Mësuesja është poete, artiste, pedagogje

Mësuesja Bytyqi në intervistën për gazetën tonë shpalos kujtime nga etapa të ndryshme të punës dhe përkushtimit të saj në këtë mision njerëzor për edukimin e brezave. Punoj në atdhe në etapa ... (faqe 3)

SBASHK-u çdo ditë po rritet

### SHFMU "Dr.Ibrahim Rugova" i bashkohet SBASHK-ut



Kolegu ynë Fadil Halimi ka dhënë kontributin e tij në numrin e këtij muaji të gazetës "Arsimimi sot"...(faqe 8)



## Editorial

### Qershori

Është muaj i rëndësishëm qershori për arsimin në Kosovë. Pas shumë muajve të punës e përkushtimit vjen koha kur mësimdhënësit bëjnë analizën e arritjeve përfundimtare të nxënësve të tyre. Punë kjo hiç e lehtë. Përballet në këto momente mësimdhënësi me kërkesën për vlerësim real e për mbyllje notash ashtu si i kanë merituar nxënësit, por përballet edhe me vizitat e lutjet e prindërve dhe besa edhe të kolegëve për “falje” notash. Mësimdhënësit janë njerëz të ndjeshëm dhe lëshojnë pe duke bërë be e rufe se në vitin e ardhshëm s’do të shkojë kështu puna e notave. Këto momente kalohen dhe mësimdhënësit përgatiten për ca ditë pushimi të merituar. Ata edhe në pushim e kanë shpesh mendjen të viti i ri shkollor, që vjen shpejt. Këtë vit shkollor kolegët tanë kudo janë, e kanë përmbyllur krenar për punën e angazhimin e bërë e duke

u zotuar se do të shtojnë edhe më angazhimet për arritje të reja vitin shkollor që po vjen.

Këta njerëz të dijes janë unik në SBASHK dhe po përgatiten edhe për të përballuar sfidat që i presin. SBASHK-u ka bërë publike kërkesat reale dhe është në pritje të formimit të institucioneve. Pavarësisht përbërjes së këtyre institucioneve SBASHK-u do të vazhdojë me angazhimet e përpjekjet për arritje të reja me dialog e nëse kjo nuk sjell rezultatet e pritura, atëherë mund të kemi edhe greva e veprime të tjera sindikale.

Urojmë që vitin e ri shkollor ta nisim me lajme të mira e me realizime kërkesash të anëtarësisë sonë.

Kolegë e kolege kudo jeni e keni merituar pushimin dhe ne urojmë që të kaloni sa më mirë. Takohemi bashkërisht me tingujt e ziles së parë në shtatorin 2017.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org)

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

**Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)

Tel. +381(0)38/ 226 940



## Intervista

*Intervistë me mësuesen Idrisha Bytyqi*

### Mësuesja është poete, artiste, pedagoge



*Mësuesja Bytyqi në intervistën për gazetën tonë shpalos kujtime nga etapa të ndryshme të punës dhe përkushtimit të saj në këtë mision njerëzor për edukimin e brezave. Punoj në atdhe në etapa të vështira të kombit tonë. Punoj me tërë mundësitë e saj edhe me fëmijët shqiptar*

*në gyrbet duke shtuar te ta dashurinë për gjuhën, traditën dhe kulturën e kombit të tyre. Ajo vlerëson shumë angazhimet e SBASHK-ut për të apeluar që të vazhdohet kështu me korrektësi e unitet për realizimin e kërkesave të anëtarësisë.*

#### Arsimimi Sot:

Kush është Idrisha Bytyqi ?

#### Bytyqi:

U lindi më 18 gusht 1956 në Ferizaj. Pasi përfundova Normalen në Ferizaj fillova me profesionin aq të dashur dhe me misionin për edukimin e brezave në Firajë. Isha mësuesja e parë në këtë fshat dhe atje nga respekti me quanin edhe Afërdita. Kam punuar edhe në fshatin Gaçkë e më pastaj edhe në Ferizaj në vitet 81-83, por më larguan nga puna për shkaqe politike . Pas kësaj kam emigruar në Gjermani me burrin dhe dy fëmijët dhe deri në vitin 2000 kam qenë e angazhuar si mësuese në tri shkolla në mësimin në gjuhën shqipe. Atje kam punuar me 150 nxënës me planet e programet e Republikës së Kosovës. Në qershorin e vitit 2000 jam kthyer në Ferizaj dhe fillova të punoj në shkollën e fshatit Komogllavë. Ndjem krenare që kam plotësuar dëshirën e prindit tim që të bëhem mësuese. Po ashtu jam krenare që punova me aq përkushtim me fëmijë shqiptar në Gjermani duke arritur rezultate e suksese të larta. Jam krenare, pra që i plotësova dëshirën e madhe prindit tim që të bëhesha mësuese. Jam krenare edhe për arritjet e nxënësve të mi në Gjermani dhe këtu në Kosovë.

#### Arsimimi Sot:

A ju kujtohen momente të veçanta gjatë viteve e dekadave të punës suaj me nxënës?

#### Bytyqi:

Ka shumë kujtime. Një pjesë e tyre janë të mbushura me ngjarje të rënda që i përjetoj populli dhe Kosova jonë, por ka edhe momente të lumtura e që të mbushin plot krenari. Në Gjermani punoja me fëmijë shqiptarë që atje kishin shkuar nga troje të ndryshme shqiptare. Një djalë nga Malësia , atje të Hoti e Gruda kur po vizatonin fëmijët flamurin kombëtar rrëfeu me zë të lartë se si në Mal të Zi dënoheshin gjithë ata që vendosnin këtë flamur. Kujtoj me krenari edhe garat e diturisë dhe në sporte që organizonim me nxënës. Nxënësit shqiptar që unë mësoja tregonin njohur të shkëlqyera . Ata ,e kujtoj me mburrje në turnirin e futbollit , pas lojërave të mrekullueshme morën vendin e parë duke u stolitur edhe me kupën e artë. Kur flas për kujtimet duhet të veçoj edhe momentin emocionues kur u ktheva në Kosovë në qershorin e vitit 2000. Rifillova punën këtu plot mall dhe me një përkushtim të shtuar. Me punë dhe vullnet e përkushtim arrihen rezultate të larta dhe këtë angazhim e përkushtim ia kemi borxh atdheut dhe vetë profesionit tonë.

#### Arsimimi Sot:

Na bëni ju lutem një sheti nëpër vite e dekada dhe jepni vlerësimin për arsimimin dikur dhe sot?

#### Bytyqi:

Në të kaluarën populli ynë kaloi momente të vështira. Shumë familje ishin të persektuara për shkak të aktiviteteve kombëtare dhe bindjes politike. Kishte dënime e largime të vazhdueshme nga puna dhe ushtrohej përpjekja për censurë. Sot është krejt ndryshe frymojmë lirshëm në shtetin tonë dhe kemi mundësi ta shprehim mendimin tonë dhe të punojmë në shërbim të fëmijëve, pra ardhmërisë sa më të ndritur të këtij vendi.



## Arsimimi Sot:

Na jepni portretin e mësuesit të mirë sot?

## Bytyqi:

Ne që punojmë në arsim duhet të punojmë me shpirt. Mësuesi sot duhet të jetë poet, artist, psikolog dhe ta ketë dashurinë prindërore për nxënësit.

## Arsimimi Sot:

Si i vlerësoni angazhimet e SBASHK-ut ?

## Bytyqi:

Vlerëso shumë angazhimet e SBASHK-ut. Kemi krijuar bashkërisht një unitet të shkëlqyer. Transparenca dhe komunikimi me anëtarësinë është në nivel të lartë. SBASHK-u ka krijuar emër të mirë sepse vazhdimisht është në angazhime për të realizuar të drejtat dhe kërkesat e anëtarësisë. Po ashtu është dëshmuar edhe me përpjekjet e angazhimet për ngritje të vazhdueshme të cilësisë.

## Arsimimi Sot:

Cila është këshilla juaj për SBASHK-un?

## Bytyqi:

Të gjithë duhet të angazhohemi për të bërë punë të mirë e të drejtë. Duhet të vazhdohet me angazhimet për realizimin e plotë të Kontratës së re Kolektive dhe kërkesave tjera të drejta, por në të njëjtën kohë që të gjithë të punësuarit në arsim duhet të punojmë me përkushtim sepse kemi mision të shenjtë. Ne po përgatitim fëmijë që ta kenë të ardhmen sa më të ndritur.

## Arsimimi Sot:

Çka do të shtoni në fund të kësaj interviste?

## Bytyqi:

Për SBASHK-un, jo vetëm unë, por edhe gjithë kolegët e mi kanë mendim pozitiv. Lë të vazhdohet kështu. Le të ketë angazhime në shërbim të arsimit. Le t'i jepet, si edhe deri tani, hapësirë dialogut, por nëse nuk gjenden zgjidhje me dialog le të përdoren edhe veprime sindikale. Veprime sindikale, jo kur shteti nuk mundet, por kur shteti nuk do që të realizojë kërkesat tona.

## Gjatë muajit

Fotoreportazh nga bregdeti shqiptar

### 420 anëtarë të SBASHK-ut në shoqëri me valët e qeta të detit

SBASHK-u edhe këtë vit po vazhdon me traditën e mirë për dërgimin në bregdetin shqiptarë të anëtarëve të vetë nga e tërë Kosova. Me qëllim që çdo gjë këtë rrjedhë të mbarë Këshilli Drejtues ka emëruar një komision që do të bëjë gjithë përgatitjet e duhura lidhur me këtë aktivitet.



Pasi ishin kryer me përpikëri përgatitjet nga komisioni i kryesuar nga Ymer Ymeri kanë ardhur në bregdetin

shqiptar grupi i parë prej 348 anëtarëve të SBASHK-ut nga shumë komuna të Kosovës dhe Universitetet dhe sektori i kulturës. Grupi tjetër prej 72 anëtarëve kanë ardhur më pastaj në Durrës për të shijuar bukurinë e bregdetit shqiptar.



Pushuesit kanë kaluar momente të bukura të shoqëruar nga valët e qeta të detit. Në kohën kur nuk janë buzë detit ata takohen me kryetarin e SBASHK-ut dhe



bashkëbisedojnë për shumë çështje sindikale. Në mbërme ata shoqërohen nga muzika e bukur shqipe gjenden në të njëjtën valle.



Përshtypjet e para të tyre janë shumë të mira. Ata lavdërojnë SBASHK-un për gjithë angazhimet dhe arritjet dhe për traditën e mirë që po vazhdon për dërgimin e anëtarëve për pushime. Janë këta njerëz nga pjesë të ndryshme të Kosovës, por u shkon qetazi



biseda se kanë të njëjtat halle, sfida dhe gëzime. Ata kanë punuar me vite e dekada në arsimimin dhe edukimin e brezave dhe shprehin respekt për sindikatën e tyre, që si thonë vetë, i ka shpërblyer për mundin dhe angazhimet duke i sjellë bashkërisht në këtë pjesë të bukur të Shqipërisë.



## Për komisionin nuk ka pushim

Derisa anëtarët e SBASHK pushojnë e kënaqen se biseduari e së dëgjuari këngë të bukura shqipe, kryetari i komisionit Ymer Ymeri i ndihmuar nga Afërdita Ahmeti, Vlora Rexhepi Berisha, Blendor Shatri dhe anëtarët nga 7 anët e Kosovës Bajram Shala, Avdullah Bujupi, Emine Rashiti, Feriz Jashari, Avdullah Krasniqi, Nasibe Kermeni, Xhevahire Haxhiu dhe Mamudije Rudi nuk e kanë këtë luks. Ata janë në takime e konsultime të vazhdueshme.



Me sukses e kanë kaluar sfidën e parë dhe pa telashe kanë akomoduar pushuesit. Pas kësaj ata janë marrë edhe me numrin e çadrave dhe me çështje të tjera në mënyrë që pushuesit të jenë plotësisht të relaksuar. Takimet e këtij komisioni janë vërtetë serioze. Anëtarët e komisionit raportojnë për ditën e kaluar të pushimeve dhe marrin edhe këshilla për veprimet në vijim. “Ne nuk kemi ardhur për të pushuar, po për të kryer me përpikëri detyrat në shërbim të pushuesve nga e tërë Kosova”, shprehet secili prej tyre dhe vazhdojnë angazhimet sa te plazhi e sa te restoranti e veranda. Me ta është edhe kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, i cili takohet vazhdimisht me pushuesit dhe u jep përgjigje në pyetjet që ata shtrojnë. Atmosferë vërtetë e bukur kjo.





Në ditën e fundit të këtij aktiviteti rekreativ shumë nga pushuesit do të shkruajnë në fletoret e SBASHK-ut përshtypjet e tyre. “ Këto përshtypje do t’i marrim dhe do t’i lexojmë e analizojmë me kujdes për të parë lëvdatat, por edhe ndonjë vërejtje e kritikë me të vetmin qëllim që ky aktivitet të jetë edhe më mirë i përgatitur verën e ardhshme”, shprehet kryetari i komisionit, Ymer Ymeri, teksa dëgjon me kujdes raportet e kolegëve të tij të komisionit.

Bashkëbiseda me pushuesit për çështje arsimore e sindikale



Momentet kur nuk janë buzë detit pushuesit i shfrytëzojnë për të bashkëbiseduar me njëri-tjetrin e për të bartur përvoja lidhur me çështje arsimore dhe për kurikulin e ri. Ata po ashtu takohen në grupe me kryetarin e SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, me menaxherin për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri dhe me juristin Blendor Shatri për të shtruar pyetje të shumta e për të marrë përgjigje lidhur me çështjet aktuale. Pyetjet më të shpeshta kanë të bëjnë me përmbajtjen e Kontratës së re Kolektive të Arsimit.

Kolegët tanë na shkruajnë nga mjediset e tyre të punës

## Aktivitetet e SBASHK-ut nuk kanë të ndalur

Veprimtarët e SBASHK-ut Bardh Bardhi e Blerim Mehmeti, krahas angazhimeve sindikale në mjediset e tyre të punës e aktivitetit, kanë treguar se kanë talent edhe në profesionin e gazetarisë. Ata për gazetën tonë kanë dërguar informacione për angazhimet e përditshme të SBASHK-ut.



Një ide , që merr formën e kërkesës , nga një numër pushuesish është edhe çështja e shtrimit të kërkesës nga SBASHK që të zvogëlohet nga 65 në 60 vjet për meshkujt dhe në 55 vjet për femrat moshë e daljes në pension.



Mbështetësit e kësaj kërkesë sjellin argumente se puna e përkushtuar me vite e dekada e tyre në edukimin dhe arsimimin e brezave ka lënë gjurmë te ta dhe se , si thonë, është mirë që arsimit të freskohet me kuadro të reja, numri i të cilëve nuk është i vogël e që presin punë me vite. Kjo çështje do të ngrihet në mënyrë zyrtare nga SBASHK te organet gjegjëse arsimore me shpresën se do të analizohet detajisht dhe me seriozitet për të marrë përgjigje meritore.



“SBASHK-u e ka shpallur vitin 2017 vit zgjedhor dhe Këshilli Drejtues ka caktuar edhe agjendën e zgjedhjeve nëpër shoqata sindikale të institucioneve arsimore në Arsimin Parauniversitar dhe në njësitë akademike . Kjo agjendë është duke u respektuar kështu që edhe në UP zgjedhjet kanë një rrjedhë të mirë. Në kuadër të këtij aktiviteti me rëndësi është mbajtur edhe takimi zgjedhor i shoqatës sindikale të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë. . Kryetar i sindikatës në Fakultetin e Bujqësisë e Veterinarisë u zgjodh Muharrem Berisha, i cili u zotuar se do të angazhohet me gjithë mundësitë për të qenë zë i fuqishëm sindikal nga kjo njësi akademike



Duhet shtuar se në hapje të këtij takimi zgjedhor kryetari i SUSHK-ut, që është pjese SBASHK-ut, Bardh Bardhi ka rikujtuar se viti 2017 është vit i zgjedhjeve në SBASHK e pastaj është ndalur të arritjet dhe sfidat. Kryetari Bardhi është shprehur se falë angazhimit të vazhdueshëm të SUSHK-ut dhe SBASHK-ut në tërësi janë shënuar arritje të dukshme. Ai ka kujtuar se pas shumë angazhimesh është arritur të realizohet kërkesa për shkriren në pagën bazë të pjesës stimulative për të punësuarit në administratë, realizimin e kërkesës për 0.5 % për çdo vit të shërbimit dhe arritjen e madhe të SBASHK me nënshkrimin e Kontratës së re Kolektive, në të cilën për të parën herë është përfshirë edhe Arsimi i lartë , pra SBASHK dhe MASHT më 18 prill 2017 nënshkruan Kontratë Kolektive për tërë sistemin arsimor në Kosovë.

Edhe kolegu ynë nga Gjilani Blerim Mehmeti ka dhënë kontributin e tij në përgatitjen e gazetës sonë të muajit qershor. “Këshilli Drejtues si organ më i lart i organizimit sindikal e ka paracaktuar agjendën e zgjedhjeve nëpër shoqata dhe institucione arsimor si



në ato të arsimit parauniversitar edhe ato universitar. Kjo agjendë është duke u respektuar edhe nga Komuna e jonë. Zgjedhjet janë mbajtur gati se në të gjitha institucionet arsimore.

Komuna e jonë i ka 37 institucione arsimore dhe gati se në të gjitha këto institucione janë mbajtur zgjedhjet dhe janë kryer me sukses. Jemi drejt finalizimit dhe përmbylljes së këtij procesi shumë të rëndësishëm të



organizimit sindikal. Nga këto zgjedhje lirisht mund të nxjerrim përfundime se po dalim më të konsoliduar dhe në numër më të madh, që donë të thotë se numri i anëtarësisë po rritet çdo ditë e më tepër. Shoqatat Sindikale i kanë konvokuar që nga muaji shkurt Kuvendet zgjedhore dhe në to është debatuar gjerë e gjatë për veprimtarinë sindikale qoftë në rrafshin lokal, qoftë në rrafshin republikan. Punëtorët arsimorë janë shumë të kënaqur me aktivitetet sindikale dhe të arriturat brenda kësaj periudhe katër vjeçare”, tregon Blerimi.

SBASHK-u çdo ditë po rritet

## SHFMU "Dr.Ibrahim Rugova" i bashkohet SBASHK-ut

Kolegu ynë Fadil Halimi ka dhënë kontributin e tij në numrin e këtij muaji të gazetës "Arsimimi sot". Ai ka përvojë të dëshmuar në gazetari dhe prandaj shkrimin e tij po e botojmë të plotë dhe ashtu si e ka dërguar ai në redaksinë e gazetës sonë.



Sindikata e AF dhe e AM të Podujevës në kuadrin e aktivitetit sindikal, sot ka zgjedhur kryesinë dhe kryetarin e Shoqatës Sindikale të SHFMU "Dr.Ibrahim Rugova". Në këtë mbledhje ku ishte i pranishëm edhe kryetari i SAF e SAM të Podujevës, Fadil Halimi, mësimdhënësit e kësaj shkolle kanë zgjedhur Kryesinë

prej 7 anëtarëve, kryetar arsimtarin Behar Hasanin dhe nënkryetare, mësuesen Magbule Shehollin. Në hapje të takimit, kryetari i SAF e SAM të Podujevës, ka përshëndetur anëtarët e rinj të SBASHK-ut, pastaj ka bërë një pasqyrim të angazhimeve, arritjeve dhe sidave të sindikalistëve të arsimit në këtë komunë.

Ai po ashtu në kuadër të bashkëbisedimit me anëtarët e Shoqatës sindikale të shkollës "Dr.Ibrahim Rugova" u është përgjigjur shumë pyetjeve për çështje të caktuara sindikale. Pjesëmarrësit në këtë takim kanë lavdëruar angazhimet e SBASHK-ut të udhëhequr nga kryetari Rrahman Jasharaj . Ndërsa falë një përkushtimi të tillë do të vazhdohet suksesshëm në realizmin e kërkesave të anëtarësisë. SBASHK-ut i janë bashkangjitur edhe Shkollat fillore të Mesme të ulëta të qytetit "Shaban Shala" e Enver Maloku" Sindikata komunale e Arsimit të Podujevës me sukses është duke e përmbyllur edhe procesin zgjedhor të Shoqatave sindikale të shkollave të kësaj komune

## SBASHK-u po fiton në gjykatë betejat me komunat



Dega në Vushtri e Gjykatës Themelore në Mitrovicë ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e SBASHK-ut. Në këtë mënyrë

SBASHK-u fitoi në gjykatë betejën e parë me komunat dhe të 13 anëtarët e pensionuar të kësaj sindikate do të marrin vlerën e 3 pagave në emër të shpërblimit jubilar dhe vlerën e 3 pagave në emër të pagave përcjellëse me rastin e pensionimi.

SBASHK-u kishte provuar që përmes takimeve e me dialog me institucionet e pushtetit lokal të realizojë të drejtën e garantuar në nenin 36 të Kontratës Kolektive

për të punësuarit në arsim, që janë anëtarë të SBASHK, që me rastin e pensionimit të gëzojnë shpërblimet jubilarë dhe tri pagat me rastin e pensionimit . Qeveritë komunale kishin hezitur ta kryenin këtë obligim dhe prandaj SBASHK-u kishte grumbulluar dokumentacionin e duhur për anëtarët e vetë të pensionuar në vitet 2015 e 2016 dhe kishte ngritur padi në gjykatat gjegjëse në të gjitha komunat e Kosovës.

E para ka nisur procedurën dhe ka mbajtur dy seanca lidhur me padinë e SBASHK-ut ndaj komunave Dega në Vushtri e Gjykatës Themelore në Mitrovicë. Kjo gjykatë pasi ka dëgjuar mbrojtjen e SBASHK-ut dhe



# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

SBASHK-u fitoi në gjykatë betejën e parë me komunat dhe të 13 anëtarët e pensionuar të kësaj sindikate do të marrin vlerën e 3 pagave në emër të shpërblimit jubilar dhe vlerën e 3 pagave në emër të pagave përcjellëse me rastin e pensionimit.

SBASHK-u pret që shumë shpejtë edhe gjykatat nëpër komunat tjera të nisin me seancat dhe me procedurën e dëgjimit të palëve dhe të administrimit të provave në

mënyrë që gjithë anëtarët e kësaj sindikate të pensionuar në vitet 2015 e 2016 të marrin shumën e 6 pagave , ashtu si ua garanton Kontrata Kolektive e nënshkruar nga SBASHK dhe MASHT.

Vlen të kujtohet se këtë të drejtë e gëzojnë vetëm të punësuarit në arsim që janë anëtarët e SBASHK

